



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

RAPORTI VJETOR

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

JANAR -DHJETOR 2023

Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIMET	2
1. Hyrje	3
2. Veprimtaria e kryer nga QKB gjatë periudhës kohore Janar– Dhjetor 2023	3
2.1 Mbi përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga QKB-ja	3
2.2 Mbi aplikimet e trajtuara nga strukturat përgjegjëse	5
3. Mbi kuadrin ligjor dhe iniciativat ligjore.....	8
3.1 Mbi iniciativat ligjore të propozuar për ndryshime në kuadër të procesit të riinxhinierimit dhe derregullimit në fushën e regjistrimit, licencimit/lejimit/autorizimit të biznesit	8
4. Mbi angazhimin e QKB-së në kuadër të integritetit dhe raportimit në BE.....	9
4.1 Raportimi për International Co-operation Review Group (ICRG)’s Financial Action Task Force (FATF)	9
4.2 Mbi angazhimin e QKB-së në kuadër të integritetit në BE	12
5. Aktivitetet dhe pjesëmarrje në grupe pune	12
5.1 Pjesëmarrje në takimin rajonal, për ecurinë e zbatimit të angazhimeve të Udhëzuesit; Antikorrupsioni dhe Financimet e paligjshme (Roadmap) dhe ecurinë e tij në parapregatitje të konferencës rajonale antikorrupsion, për tu zhvilluar në 26-27 Shtator 2023.....	12
5.2 Angazhimi i QKB mbi plotësimin e kërkesave për certifikimin me Standardin ISO 9001:2015.....	13
5.3 Pjesëmarrje në European Business Registry Association (EBRA) [Shoqata e Regjistrave Tregtarë Europianë].....	13
5.4 Vlerësimi i praktikave në vendet e rajonit.	14
5.5 Pjesëmarrja në Portalin Rajonal të Regjistrave Tregtar të Europës Juglindore (BIFIDEX)	15
5.6 Mbi vizitën e delegacionit të Kosovës në Qendrën Kombëtare të Biznesit.....	16

5.7 Marrëveshje Bashkepunimi.....	16
5.8 Plani Kombëtar OGP 2022-2024	17
6. Mbi trajtimin e ankesave dhe proceset gjyqësore.....	17
6.1 Mbi trajtimin e ankesave.....	17
6.2 Mbi proceset gjyqësore.....	18
7. Mbi menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimet e brendshme.....	18
8. Analiza e realizimit të treguesve ekonomiko-financiar	20
9. Objektivat për vitin 2024	21
ANEKS 1.....	22
ANEKS 2.....	24
ANEKS 3.....	27
ANEKS 4.....	28

SHKURTIMET

AKSHI – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

ILDKPKI – Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

KLGI – Këshilli i Lartë Gjyqësor

KPK – Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

OECD – Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

HRMIS – Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

RT – Regjistri Tregtar

RKLLA – Regjistrin Kombëtar të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve

RPP – Regjistri i Pronarëve Përfitues

FATF – Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar

Moneyval – Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave

1. Hyrje

Qendra Kombëtare e Biznesit është institucion i administratës shtetërore me personalitet juridik në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Viti 2023 për Qendrën Kombëtare të Biznesit, shënoi rezultate të larta falë mirëadministrimit dhe përmirësimit të ndjeshëm të shërbimeve online. Këto ndryshime u reflektuan duke përmirësuar transparencën, përgjegjshmërinë, rritjen e sigurisë, digjitalizimin dhe rendimentin. Qëllimi i punës së QKB-së mbetet ofrimi i një shërbimi sa më cilësor dhe krijimi i një kulture administrative të biznesit.

Qendra Kombëtare e Biznesit i ushtron funksionet e saj bazuar në Ligjin Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 10081, datë 23/02/2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 112/2020, “Për Regjistrin e Pronarit Përfitues”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Të motivuar e të përkushtuar me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit, në vijim është “Raportin Vjetor 2023”, i Qendrës Kombëtare të Biznesit, i përmbledhur si një pasqyrë transparente e të gjitha arritjeve tona.

2. Veprimtaria e kryer nga QKB-ja gjatë periudhës kohore Janar– Dhjetor 2023

Qendra Kombëtare e Biznesit gjatë vitit 2023 ka ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e regjistrimit, licencimit/lejimit/autorizimit të biznesit dhe regjistrimit të pronarëve përfitues.

Gjatë ushtrimit të kompetencave të institucionit për vitin 2023 në fokus të punës së strukturave përgjegjëse të Qendrës Kombëtare të Biznesit ka qenë ofrimi i të gjithë shërbimeve online nëpërmjet portalit qeveritar e-albania.

2.1 Mbi përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga QKB-ja

Me qëllim realizimin e fokusit kryesor të QKB-së, drejtë përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve ndaj qytetarëve përmes lehtësimit të procedurave, ofrimit të shërbimeve më pranë qytetarëve online përmes platformës e-Albania, përgjatë vitit 2023 është realizuar përmirësimi

i 38 shërbimeve në Regjistrin Tregtar, 9 shërbimeve në Regjistrin Kombëtar të Licencave/Lejeve/Autorizimeve dhe përmirësimin e 3 shërbimeve në Regjistrin e Pronarëve Përfitues. Përmes digjitalizimit të shërbimeve është bërë e mundur që këto shërbime të jenë më të shpejta, më të lehta dhe më të aksesueshme.

Një tjetër risi e vitit 2023, është mundësia që i është krijuar çdo individ i pajisur me nënshkrim elektronik dy javor, pa pagesë, me qëllim realizimin e kryerjes së aplikimit në përputhje me dispozitat ligjore, duke bërë të mundur realizimin e nënshkrimit të formularit të aplikimit nga vetë individ i ose çdo person tjetër i autorizuar për të kryer këtë veprim, duke ulur koston e subjekteve tregtare. Ky shërbim është mundësuar si për shtetasit shqiptarë dhe për ata të huaj.

Gjithashtu, një tjetër arritje është realizimi tërësisht i procedurave të shqyrtimit të aplikimit në përputhje me dispozitat ligjore, duke bërë të mundur kthimin e paplotë të aplikimit në llogarinë e subjektit në e-Albania, plotësimin e tij nga subjekti dhe rikthimin në regjistrin tregtar. Është mundësuar njoftimi i statusit të aplikimit në llogarinë e subjektit në e-Albania, në rubrikën “mesazhet e mia”, si edhe nëpërmjet njoftimit me anë të mesazhit në numrin e telefonit dhe adresën e email-it të deklaruar në e-Albania. Gjithashtu është mundësuar njoftimi i arsyeve të pezullimit/refuzimit të aplikimit në hapësirën “Dokumentat e mia”, në llogarinë e subjektit në e-Albania. Ndërkohë kur aplikimi ka statusin “Miratuar”, në rubrikën njoftime në e-Albania, individit i dërgohen të dhënat e NUIS/NIPT me të cilin është pajisur.

Qendra Kombëtare e Biznesit ka mundësuar gjithashtu riformatimin e disa shërbimeve në një të vetëm, psh. “Aplikimi për regjistrimin fillestar të lejeve dhe licensave”, tashmë është vetëm 1 shërbim.


Gjithashtu është bërë i mundur plotësimi online i formularëve, konkretisht “**Formular Ankese**” dhe “**Formular Kërkesë Informacioni**”, të cilët gjenden në faqen e web-it të QKB-së, në adresën: www.qkb.gov.al, lehtësisht e aksesueshme për individët, duke shkurtuar kohën e marrjes së shërbimeve, duke garantuar cilësinë dhe shpejtësinë e ofrimit të shërbimit, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, aksesit, efikasitetit, barazisë dhe bashkëpunimit.

Me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe me fokus krijimin e lehtësirave për subjektet çdo ditë e më shumë, Qendra Kombëtare e Biznesit në faqen zyrtare të web, në rubrikën “Kontakt”, “Pyetësori”, ka bërë të mundur për individët të cilët përdorin faqen e QKB-së (www.qkb.gov.al), kryerjen e vlerësimit të marrjes së shërbimit nëpërmjet plotësimit nga ana e tyre të pyetësorit të vlerësimit, i cili vlen për Qendrën Kombëtare të Biznesit për rritjen e angazhimit për secilën hallkë të veprimtarisë së saj në shërbim të biznesit dhe qytetarëve.


2.2 Mbi aplikimet e trajtuara nga strukturat përgjegjëse

Përgjatë vitit 2023, janë trajtuar në total **177, 899** aplikime në të tre regjistrat e administruar nga QKB-ja, nga të cilat:

1. Janë trajtuar gjithsej **157, 873** aplikime në Regjistrin Tregtar (ANEKSI 2), nga të cilat:
 - **120,450** aplikime për regjistrime fillestare, ndryshime, pezullime, aktivizime, çregjistrime;
 - **37, 423** janë aplikime për dorëzim të pasqyrave financiare.





2. Janë trajtuar gjithsej **12, 074** aplikime në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve (ANEKSI 3)



3. Janë trajtuar në total **7,952** aplikime në Regjistrin e Pronarëve Përfitues (ANEKSI 4):

- **7, 570** aplikime nga Subjektet tregtare;
- **382** aplikime nga Organizatat jo fitimprurëse.





Janë asistuar nëpërmjet email-it dhe telefonatave të gjithë subjektet të cilët kanë kontaktuar QKB-në, për të zgjidhur problemet e hasura gjatë aplikimeve me të dhënat, si më poshtë:

- Nga 1 Janar 2023 deri në 31 Dhjetor 2023 janë trajtuar rreth 69,893 e-maile të mbërritura në Qendrën Kombëtare të Biznesit nëpërmjet kanaleve të komunikimit zyrtar: info.qkb@qkb.gov.al; asistencaonline@qkb.gov.al; si dhe dritareve të komunikimit të publikuara në websitin “Kërkesë Informacioni” dhe “Ankesë”.
- Janë asistuar subjektet nëpërmjet linjës telefonike me mesatarisht 60 telefonata në ditë ose rreth 15,120 telefonata gjatë vitit 2023, ku janë sqaruar mbi pyetjet mbi mënyrën e aplikimit në portalin e-albania, procedurën që ndiqet në aplikim, dokumentacionin e nevojshëm, janë sqaruar mbi ecurinë e aplikimeve apo problematikat e hasura gjatë aplikimit.

Janë trajtuar brenda afateve ligjore të gjithë shkresat e paraqitura nga subjektet për pajisjen me kopje të njejtë me origjinalin të dosjes elektronike:

- Nga 1 Janari 2023 deri më 31 Dhjetor 2023 janë trajtuar 255 kërkesa.

Janë trajtuar brenda afateve të gjithë korrespondenca me drejtoritë rajonale tatimore në lidhje me dërgimin e certifikatave të çregjistrimit të subjekteve:

- Nga 1 Janari 2023 deri në 31 Dhjetor 2023 janë dërguar 3,384 certifikata çregjistrimi.

Ndërkohë, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, QKB-ja trajton kërkesa për informacion

për të dhënat e regjistruara dhe të publikuara në të tre regjistrat që administrohen nga QKB-ja, që vijnë nga Prokuroria, Gjykatat, ILDKPKI, KLGJ, KPK, Përmbaues, etj.,

Të gjitha kërkesat e administruara nga QKB-ja gjatë vitit 2023, janë trajtuar brenda afateve ligjore dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

3. Mbi kuadrin ligjor dhe iniciativat ligjore

3.1 Mbi iniciativat ligjore të propozuara për ndryshime në kuadër të procesit të riinxhinierimit dhe derregullimit në fushën e regjistrimit, licencimit/lejimit/autorizimit të biznesit.

Qendra Kombëtare e Biznesit, me qëllim përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e licencimit/lejimit/autorizimit dhe regjistrimit të biznesit, ka ndërmarr iniciativën për ndryshime ligjore në kuadër të procesit të riinxhinierimit dhe derregullimit. Ndryshimet e propozuara për Ligjin Nr. 131/2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"; Ligjin Nr.10081, datë 23/02/2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, hartohen në kuadër të lehtësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarët duke respektuar parimet e ligjshmërisë, aksesit, efikasitetit, barazisë dhe bashkëpunimit. Këto ndryshime reflektojnë realizimin e ofrimit të shërbimeve vetëm online nëpërmjet platformës e-albania, paralelisht duke rritur cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe duke reduktuar kohën e marrjes së këtyre shërbimeve. Këto ndryshime gjithashtu kanë si qëllim zgjidhjen e problemeve të ndeshura në praktikën e zbatimit të ligjit, sigurimin e përputhshmërisë me Kodin e Procedurave Administrative dhe përmirësimin e thjeshtësimin e mëtejshëm të proceseve për të ulur kostot dhe kohën për biznesin dhe vetë QKB-në.

Në ndryshimet e Ligjit Nr. 131/2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", synohet ofrimi i shërbimeve vetëm online nëpërmjet platformës e-albania dhe shtimin në kompetencat e QKB-së, administrimin e regjistratit të pronarëve përfitues.

Në Ligjin Nr. 10081, datë 23/02/2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, janë draftuar ndryshimet e mundshme të legjislacionit të sipërcituar përsa i përket heqjes së tarifës së shërbimit pasi aplikimet për pajisje me leje/licenca/autorizime kryhen on-line, kundrejt asnjë tarife; parashikimi i një vendimi të pezullimit si hallkë e ndërmjetme, përpara marrjes së vendimit përfundimtar duke i dhënë mundësi subjektit të plotësojë mangësitë e konstatuara; rishikimi i procedurës së miratimit në heshtje; përcaktimi i qartë i organit kompetent që bën revokimin.

Në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar", janë draftuar ndryshimet e mundshme të legjislacionit përsa i përket afateve të shqyrtimit të aplikimeve, personat që lejohen të bëjnë aplikimin për regjistrimin fillestar të personave juridikë, formën e paraqitjes së dokumentave në aplikim, emërtimin e shoqërive tregtare, mënyrën e njoftimit të subjekteve për miratimin, pezullimin dhe refuzimin e aplikimeve.

4. Mbi angazhimin e QKB-së në kuadër të integritetit dhe raportimit në BE

4.1 Raportimi për International Co-operation Review Group (ICRG)'s Financial Action Task Force (FATF)

Në datat 28-29 Gusht 2023 ekspertët e ICRG-së realizuan një vizitë në Shqipëri me temat si më poshtë:

- Mbajtja e të dhënave të përditësuara dhe të verifikuara sipas detyrimeve ligjore për transparencë. Ky sesion përfshiu një demonstrim të shkurtër të drejtpërdrejtë të Regjistrimit të Pronarëve Përfitues duke përfshirë edhe kontrole mbi dosje të subjekteve raportuese;
- Demonstrimi i aksesit në kohë reale nga autoritetet kompetente në informacione për pronarët përfitues të Subjekteve juridikë dhe OJF;
- Sigurimi i një kuadri ligjor adekuat për shkeljet e detyrimeve të regjistrimit për subjektet juridike dhe OJF-të.

Në Progres Raportin për Shqipërinë pjesë të rëndësishme kanë edhe rekomandimet nga grupi i ekspertëve të FATF/ICRG ku janë vlerësuar të adresuara gjerësisht (mbi nivelin e gjendjes “zonë gri”).

Nga Komiteti i MONEYVAL dhe ICRG/FATF, në kuadër të procesit të vlerësimit të vendit për Qendrën Kombëtare të Biznesit kryesisht për Regjistrin Tregtar dhe Regjistrin e Pronarëve Përfitues deri në raportin e fundit të realizuar në shtator të 2023 kanë qenë rekomandimet si më poshtë:

1. Shqipëria duhet të krijojë një mekanizëm ligjor që garanton që të dhënat e depozituara sipas detyrimeve ligjore të transparencës të jenë të përditësuara dhe të verifikuara siç duhet nga QKB dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.	Gusht 2021	Adresuar (Addressed)
---	------------	-------------------------

2. Shqipëria duhet të ndërmarrë hapa shtesë për të siguruar që ka mekanizma efektivë për aksesin në kohë nga autoritetet në informacionin për pronarët përfitues të personave juridikë, me gjoba të përshtatshme për mospërputhje dhe dhënien e informacionit të rremë, për shembull duke krijuar regjistrin e pronarëve përfituese, e cila është në zhvillim e sipër	Tetor 2021	Adresuar gjerësisht (Largely Addressed)
3. Shqipëria duhet të sigurojë një kuadër ligjor të përshtatshëm për shkeljet e detyrimeve të regjistrimit për Subjektet tregtare dhe OJF-të dhe të zbatojë sanksione më proporcionale dhe bindëse, të cilat marrin parasysh barazinë e fuqisë blerëse	Gusht 2021	Adresuar gjerësisht (Largely Addressed)

Ekipi në terren zbuloi se procesi i zbatimit të reformave dhe veprimeve të kërkuara është plotësisht i realizuar në Shqipëri dhe po vazhdon. Ekipi konfirmoi gjithashtu se ka një angazhim politik të nivelit të lartë për të zbatuar dhe vazhduar përmirësimin e kuadrit shqiptar të AML/CFT/CPF. Në përfundim raporti i ekspertëve për Qendrën Kombëtare të Biznesit në raportin final mbi të cilin Shqipëria doli nga zona gri, përfshiu si më poshtë realizimin e rekomandimeve:

Për pikën 1:

- Shqipëria ka krijuar një mekanizëm ligjor për përditësimin e të dhënave për transparencën e subjekteve juridike në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) duke futur një proces me dy hapa për kontrollimin dhe pranimin e të dhënave dhe refuzimin e regjistrimit të të dhënave të paplota ose jokonsistente.
- Në lidhje me OJF-të, Shqipëria nxori një ligj të ri “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” me rregulla të detyrueshme për regjistrimin e OJF-ve dhe digjitalizimin e të dhënave në një bazë të re të dhënash. Ekzistonte një regjistër elektronik i OJF-ve. Regjistrimi dhe verifikimi sigurohet nga gjyqtari i seksionit tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.
- Autoritetet shqiptare ndryshuan nivelin e sanksioneve administrative për të siguruar që sanksionet proporcionale dhe bindëse janë në fuqi në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të regjistrimit. Sanksionet penale mund të zbatohen nëse informacione të rreme i jepen qëllimisht QKB-së.

- Këto përpjekje kanë patur rezultate. Ka pasur raste kur janë identifikuar pasaktësi dhe informacioni është përditësuar përmes kanaleve të shumta. Janë aplikuar sanksione administrative dhe gjithashtu rastet kur të dhënat e QKB janë korrigjuar në bazë të Urdhrave të Gjykatës. Përveç kësaj, autoritetet kanë filluar të zbatojnë një sistem të "flamurit të kuq" për të shënuar informacionin e vjetëruar ose të pasaktë të mbajtur nga QKB/Gjykatat.

Për pikën 2

- Shqipëria nxori ligjin “Për regjistrin e pronarëve përfitues” duke krijuar një regjistër për pronarët përfitues që u bë funksional më 1 shkurt 2021. Regjistri administrohet nga QKB-ja. Të gjitha subjektet dhe organizatat jofitimprurëse janë të detyruara të regjistrojnë në regjistër pronarët e tyre përfitues (përfshirë ndryshimet në lidhje me pronarët përfitues) brenda afateve specifike që mbikëqyren nga QKB-ja.
- Të gjitha subjektet dhe organizatat jofitimprurëse janë të detyruara të regjistrojnë në regjistër pronarët e tyre përfitues (përfshirë ndryshimet në lidhje me pronarët përfitues) brenda afateve specifike që mbikëqyren nga QKB-ja.
- Këto përpjekje kanë patur rezultate. Që nga 30 qershori 2023, regjistri i pronarëve përfitues është i populluar me afërsisht 97,5% të personave juridikë dhe 94,75% të OJF-ve. Të dhënat e pronarëve përfitues në regjistër janë përdorur nga autoritetet kompetente si DPPP, AKK dhe AMF në masë të ndryshme.

Për pikën 3

- Shqipëria ka modifikuar nivelin e sanksioneve në lidhje me dështimin e detyrimit të regjistrimit në regjistrin tregtar duke katërfishuar sanksionet. Shqipëria miratoi një regjim sanksionesh bindëse për mospërmbushje të detyrimit për të paraqitur informacionin e pronarëve përfitues. Gjithashtu, Shqipëria miratoi një nivel të ri sanksionesh administrative për OJF-të.
- Shqipëria ka demonstruar se janë aplikuar penalitetet e duhura për mospërmbushje të detyrimit për të paraqitur informacionin e pronarëve përfitues, të cilat kanë pasur efekt korrigjues në kuptimin që subjektet e gjobitura më vonë kanë dhënë informacionin e tyre për pronarët përfitues. Gjithashtu, janë aplikuar sanksione administrative dhe rastet kur të dhënat e QKB-së janë korrigjuar në bazë të Urdhrave të Gjykatës.

4.2 Mbi angazhimin e QKB-së në kuadër të integrimit në BE

Gjatë vitit 2023 QKB-ja ka marrë pjesë në takimet e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës dhe takimet shpjeguese për Kapitullin 3, 6, 18, 20, 23 dhe Kriterin Ekonomik. Në vijim të detyrave të përcjella nga ministria përgjegjëse, nga struktura përkatëse, e institucioni janë përgatitur dhe plotësuar informacioni për udhëzuesin informues dhe prezantimet për takimet dypalëshe me shërbimet e BE-së për kapitullin 3, 6 dhe Kriterin Ekonomik.

5. Aktivitetet dhe pjesëmarrje në grupe pune

5.1 Pjesëmarrje në takimin rajonal, për ecurinë e zbatimit të angazhimeve të Udhëzuesit; Antikorrupsioni dhe Financimet e paligjshme (Roadmap) dhe ecurinë e tij në parapregatitje të konferencës rajonale antikorrupsion, për t'u zhvilluar në 26-27 Shtator 2023

Në 26-27 Shtator 2023, u zhvillua takimi në kuadër të projektit rajonal të Ballkanit Perëndimor, të zbatuar nga UNODC, Udhëzuesi: “Antikorrupsioni dhe Financimet e Paligjshme (Roadmap)”, ku ndër të tjera u theksua se:

- i) Informacione mbi deklarinë dhe platformën online të deklarimit të pasurive dhe interesave private, kapacitetet dhe burimet teknike njerëzore të institucionit që merret me verifikimin e deklarimit të pasurive dhe interesave private, ecurinë, progresin dhe njohjen publike të instrumentit të pronarëve përfitues.
- ii) Informacione mbi organizimin e trajnimeve, fushatave të ndërgjegjësimit, me qëllim të thellimit të njohurive dhe rritjes së vetëdijes mbi konceptet e pronësisë së pronarit përfitues; ndërmjet të gjithë aktorëve relevantë të mbështetur në këtë proces.

Të gjithë pjesëmarrësve të takimit i'u propozua edhe kërkesa për ndërhyrje dhe ndryshime të mundshme në përmbajtjen e strukturës së Udhëzuesit, për objektivat e tij. Rishikim i një objekti, shtim të objektivave u paraqitën si kërkesë nga UNODC, të cilat mund të dërgohen edhe në formë të shkruar nga institucionet tona, në vijim.

Propozimet nga ana jonë për t'u përfshirë në roadmap janë si më poshtë:

- Krijimi i mekanizmave për sigurimin që të dhënat të jenë të përditësuara, analiza e regjistrave të përfshirë në këtë proces deri në fund të vitit 2024 dhe më tej implementimi i tij.
- Vazhdimi i implementimit të mekanizmave për sigurimin e plotësimit të regjistrat të pronarëve përfitues.
- Vazhdimi i trajnimeve mbi konceptin e pronarit përfitues, njihet dhe kuptohet nga zyrtarët publikë dhe publiku i gjerë, dhe promovohet gjerësisht nga institucionet kompetente.

5.2 Angazhimi i QKB mbi plotësimin e kërkesave për certifikimin me Standardin ISO 9001:2015

Në kuadër të projektit “Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri (CSDA), një fond i përbashkët donatorësh, i cili zbatohet nga Qeveria Shqiptare në partneritet me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe me Bashkëpunimin Austria për Zhvillim (ADC) si kontribues kryesor, bashkë me UNDP-në dhe në zbatim të kontratës së konsulencës për “Mbështetje për Çertifikimin ISO mbi Menaxhimin e Cilësisë”, QKB-ja është angazhuar për certifikimin e saj me Standardin ISO 9001:2015.

Ky certifikim do të shërbente për të siguruar produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e subjekteve dhe ato ligjore njëkohësisht, të adresojë rreziqet dhe mundësitë, të përmirësojë performancën në përgjithësi dhe të sigurojnë një bazë të shëndoshë për nismat e zhvillimit të qëndrueshëm. Janë caktuar personat përgjegjës në rolin e menaxherit të Cilësisë për Hartat e Proceseve të Punës për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Menaxherët e cilësisë në bashkëpunim me stafin e QKB-së kanë përpiluar hartat e procesit të punës. Këto harta procesi janë miratuar në datë 09.11.2023. Gjithashtu në vijim të këtij angazhimi, është ngritur Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ku çdo nëpunës ka akses për t’u njohur me të gjitha hartat e procesit. Në vijim të punës së nisur, lidhur me implementimin e kërkesave të Standardit ISO 9001:2015, është hartuar Programi i Auditimit. Auditimi i Brendshëm i Cilësisë u zhvillua në zyrat e QKB-së në datën 14.12.2023 nga Menaxherët e Cilësisë dhe ekipi i konsulencës.

Në kuadër të këtij projekti nga UNDP-ja, trupa certifikuese European Quality and Safety Control (EQSC), për të realizuar procesin e certifikimit sipas kërkesave të standardit ISO 9001:2015, gjatë fazës së parë, ka marrë nga kompania konsulente dokumentacionin e hartuar të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, dhe ka realizuar fazën e parë të auditit certifikues. Rezultati i kësaj faze është që Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në QKB është në përputhje me kërkesat e standardit ISO 9001:2015 dhe u përcaktua që faza e dytë dhe përfundimtare e auditit certifikues të kryhet në Janar 2024.

5.3 Pjesëmarrje në European Business Registry Association (EBRA) [Shoqata e Regjistrave Tregtarë Europianë]

Regjistri i Pronarëve Përfitues, nëpërmjet përfaqësueve të tij ka marrë pjesë në takime të organizuara nga EBRA në formën e takimit të Grupeve të Punës, duke synuar shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira në fushën e regjistrimit të biznesit dhe pronarëve përfitues.

Në takimin e zhvilluar në Lisbon, në datën 3-4 maj 2023, i organizuar nga EBRA. Udhëzuesi: “Zbatimi i vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë dhe impakti i këtij vendimi në Regjistrin e Pronarëve Përfitues”. Në këtë takim u diskutua:

- mbi rëndësinë e të dhënave të regjistruara të Pronarëve Përfitues si mekanizëm për të luftuar korrupsionin. Qasja e publikut me të dhënat e regjistruara shërben për të kontribuar në arritjen me efektivitet të objektivit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- informacione mbi zbatimin, ecurinë dhe masat e ndërmarra në implementimin e këtij vendimi. Në fokus të këtij takimi ishte krahasimi ndërmjet regjistrave të shteteve europiane, mbi zbatimin e këtij vendimi, se si vendimi ka prekur regjistrin e pronarëve përfitues të secilit shtet dhe mbi shkëmbimin e informacionit së cilat veprime janë ndërmarrë në implementimin e tij.
- informacione mbi aksesin në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, si dhe legjitimiteti i të tretëve për të pasur akses në të dhënat e regjistruara. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që çdo person fizik ose juridik që demonstroi një interes legjitim të ketë akses në informacionin e mbajtur në regjistrat e pronarëve përfitues duke përfshirë veçanërisht gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile për aq kohë sa ata mund të demonstrojnë interes legjitim në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

5.4 Vlerësimi i praktikave në vendet e rajonit.

Një delegacion i Qendrës Kombëtare të Biznesit të Republikës së Shqipërisë, më 23 mars 2023, i kryesuar nga Drejtoresha e Përgjithshme, Drejtoria e Kërkimit dhe Udhëheqjes Metodologjike dhe Drejtoria e Pronarëve Përfitues vizitoi Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Takimi u mbajt me ndërmjetësimin e Shoqatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar – GIZ dhe i pranishëm ishte edhe z. Ilija Bundaleski, këshilltar në Programin global për luftimin e flukseve të paligjshme financiare për Maqedoninë e Veriut.

Drejtoresha e Përgjithshme dhe ekipi nga Regjistri Qendror për Maqedoninë e Veriut, përcollën përvojat e tyre nga krijimi dhe zbatimi i Regjistrit të Pronësisë Përfituese, funksionimin e tij dhe menaxhimin e regjistrave të tjerë brenda institucionit.

Në takim u realizua një demonstrim i regjistrit të pronarëve përfitues, mënyrës së regjistrimit (një regjistër me vetëdeklarim dhe pa dokumentacion mbështetës).

Ky takim dypalësh u zhvillua në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave mes dy vendeve fqinje,

lidhur me detyrimet ligjore për regjistrimin e pronarëve përfitues nga subjektet raportuese.

Gjatë takimit, të dyja palët diskutuan mbi kuadrin ligjor të të dy vendeve, konceptin e pronarit përfitues, procedurën e ndjekur nga institucionit përkatëse për regjistrimin e të dhënave, si dhe mbi rolin që ka secili institucion gjatë këtij procesi.

Nga diskutimet e zhvilluara gjatë këtij takimi rezultuan këto aspekte kryesore të regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues nga Regjistri Qëndror i Maqedonisë së Veriut:

- Nocioni i pronarit përfitues është i njëjti në të dy legjislacionet dhe i bazuar me rekomandimet e Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të Këshillit të Evropës (MONEYVAL) dhe në përputhje me parashikimet e Direktivës së Katërt të BE 2015/849 (përditësuar nga Direktiva e Pestë);
- Metodologjia e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues në Maqedoninë e Veriut konsistonte në një proces deklarativ dhe Regjistri Qendror në Maqedoninë e Veriut administronte regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues pa një rol vendimmarrës në miratimin/pezullimin apo refuzimin e aplikimit. (Regjistrimi në formën “Simple Aprove”);

Në përfundim të këtij takimi, nga Drejtoresha e Përgjithshme e Qendrës Kombëtare të Biznesit, dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Regjistratit Qendror në Maqedoninë e Veriut, u dakordësua vijimi i këtij bashkëpunimi në drejtim të shkëmbimit të eksperiencës në fushën e regjistrimit të pronarit përfitues, por edhe të regjistrimit të biznesit.

5.5 Pjesëmarrja në Portalin Rajonal të Regjistrave Tregtar të Europës Juglindore (BIFIDEX)

- Projekt i financuar nga BERZH.
- Ky Portal, përmes një platforme elektronike, synon t'i ofrojë publikut, të dhëna nga burimet zyrtare të të dhënave të regjistrave tregtar pjesëmarrës në këtë portal, duke integruar të gjithë komponentët e domosdoshëm të portalit me infrastrukturën e këtyre regjistrave, si dhe duke siguruar nivelin më të lartë të sigurisë.
- Fillimisht ky portal do të përmbajë funksione kërkimi për subjekte të regjistruar në regjistrat tregtar pjesëmarrës në këtë portal.
- Pra, me anë të këtij portali, do të mundësohet që çdo person i interesuar mund të informohet lidhur me procedurat e regjistrimit të biznesit në shtetet e Ballkanit Perëndimor, si dhe të kryejë kërkime për subjektet e regjistruar në regjistrat tregtarë të Ballkanit Perëndimor.

- Pjesmarrja e regjistrit tregtar të administruar nga QKB është këshilluar edhe nga BB, Agjendën për Reformën e Investimeve Rajonale për Ballkanin Perëndimor (*Regional Investment Reform Agenda for the Western Balkans*), për zbatimin e reformës “Përmirësimi i politikave dhe procedurave për themelimin e biznesit (*Improving business establishment policies and procedures*)”.

5.6 Mbi vizitën e delegacionit të Kosovës në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Në datën 23 – 24 Nëntor 2023 dhe 30 Nëntor – 01 Dhjetor 2023, në Qendrën Kombëtare të Biznesit është pritur për një vizitë zyrtare delegacioni me homologët e Agjensisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë. Kjo nismë kishte si synim forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve tona dhe për të shkëmbyer përvoja, njohuri dhe praktika të mira që do të kontribuojnë në zhvillimin e përbashkët në fushën e biznesit dhe metodologjisë së ndjekur nga secili institucion në ofrimin e shërbimeve ndaj bizneseve të reja dhe atyre ekzistuese.

Gjatë këtij takimi u demonstrua ndërveprimi ndërmjet dy regjistrave, Regjistrat Tregtar dhe Regjistrat të Pronarëve Përfitues mbi aplikimin e njëkohshëm, menyren dhe afatet e shqyrtimit të aplikimeve. Ky takim nxorri në pah sfidat dhe sukseset në aspektin e regjistrimit të bizneseve në Shqipëri dhe Kosovë.

5.7 Marrëveshje Bashkëpunimi

Gjatë vitit 2023, Qendra Kombëtare e Biznesit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me:

- Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me synim angazhimin e përbashkët për t’ju ardhur në ndihmë subjekteve të reja për informimin mbi rregulloret dhe legjislacionin e punës në fuqi dhe rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve, mbi të drejtat dhe detyrimet ligjore që kanë për rritjen e standarteve dhe sigurinë në punë që lindin nga momenti i regjistrimit fillestar si biznes pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- Bordin e Mbikëqyrjes Publike, me qëllim forcimin e monitorimit dhe kontrollit të subjekteve në fushën e aktivitetit “Auditues Ligjor”, “Kontabilist i Miratuar” si dhe të profesioneve të tjera, të cilat bien ndesh me profesionin e kontabilistit të miratuar dhe audituesit Ligjor dhe gjithashtu rrit mbikëqyrjen dhe transparencën në sektorin e auditimit ligjor dhe raportimit financiar. Marrëveshja synon forcimin e mbikëqyrjes në lidhje me subjektet e regjistruara pranë QKB-së, të cilët kanë depozituar informacionin vjetor në përputhje me legjislacionin mbi audituesin ligjor, raportin e auditimit, pasqyrat financiare

dhe hartuesin e pasqyrave financiare duke kontrolluar subjektet certifikuese të tyre dhe marrjen e masave të drejtëpërdrejta ndaj shkeljeve të konstatuara.

5.8 Plani Kombëtar OGP 2022-2024

Shqipëria është pjesë e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership) me qëllim nxitjen dhe bashkërendimin e nismave konkrete në mbështetje të primeve të hapjes, transparencës, gjithëpërfshirjes dhe promovimit të vlerave të qeverisjes.

Në kuadër të kësaj iniciative, Qendra Kombëtare e Biznesit ka marrë përsipër disa angazhime që lidhen me regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues dhe përditësimin e tyre nga subjektet raportuese, sipas afateve dhe kërkesave të parashikuara në ligjin “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, i ndryshuar të cilat rendin si më poshtë:

1. Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues;
2. Vlerësimi i praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues;
3. Rishikimi i legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues. Të treja angazhimet kanë si periudhë impementimi vitin 2024.

Përsa i përket 3 angazhimeve të mësipërme, Qendra Kombëtare e Biznesit ka organizuar një takim online, me subjektet raportuese dhe grupet e interesit me tematikë “Prezantimi dhe diskutimi mbi 3 (tre) angazhimet prioritare të Qendrës Kombëtare të Biznesit në kuadër të Iniciativës për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership- OGP) dhe Planit të Veprimit me grupet e interesit”. Ky takimi ishte interaktiv dhe në panel u ushtruan pyetje për diskutim nga subjektet raportuese të cilat morën përgjigje dhe sqarime nga përfaqësuesit e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6. Mbi trajtimin e ankesave dhe proceset gjyqësore

6.1 Mbi trajtimin e ankesave

Gjatë vitit 2023 janë trajtuar mesatarisht 245 ankime administrative të përcjella në formë shkresore nga subjektet tregtare dhe 87 ankesa të përcjella nëpërmjet platformës “Bashkëqeverisje”.

6.2 Mbi proceset gjyqësore

QKB-ja gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 ka ndjekur me korrektësi dhe në zbatim të ligjit, të gjitha proceset gjyqësore, në të cilat QKB-ja është palë në proces. Më konkretisht, Qendra Kombëtare e Biznesit ka qenë palë e paditur gjatë vitit 2023 dhe nga vitet e kaluara (të cilat janë në proces) në 71 procese gjyqësore dhe palë e tretë në 14 procese gjyqësore.

- Në 19 procese gjyqësore ku QKB-ja, ka qenë palë e paditur është rrëzuar kërkesë padia;
- Në 7 procese gjyqësore ku QKB-ja ka qenë palë e paditur është pranuar kërkesë padia;
- Aktualisht në proces janë 59 procese gjyqësore ku QKB-ja është palë e paditur dhe palë e tretë.

Ndërkohë, institucioni ynë ndjek me korrektësi dhe në zbatim të ligjit të gjitha proceset gjyqësore, në të cilat QKB-ja është palë në proces, të cilat janë procese gjyqësore të mbartura gjatë viteve.

7. Mbi menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimet e brendshme

Gjatë vitit 2023 nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimet e brendshme është kryer veprimtaria e mëposhtme:

- Administrimi i dosjeve të personelit sipas legjislacionit të shërbimit civil. Plotësimi i librezave të punës, hedhja e të dhënave në Regjistrin e personelit (HRMIS) dhe Regjistrin Themeltar të personelit në kohë, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Përditësimi me të dhëna të plota të nëpunësve civil të QKB-së në HRMIS dhe raportimet mujore mbi lëvizjet, performancat, proceset gjyqësore, ngritjet në detyrë në platform në administrata.al.
- Planifikimi, menaxhimi dhe zbatimi i planit të rekrutimit, kryerja e procedurave të shpalljeve të pozicioneve vakante, analiza e krijimit të një pozicioni pune të ri etj. Gjithsej për vitin 2023 janë realizuar 14 procedura rekrutimi në shërbimin civil.
- Ndjekja e procesit të vlerësimit periodik të punonjësve, sipas formatit me objektiva të përcaktuara në formularin tip në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Ndjekja dhe azhurnimi i çështjeve për deklarimin e pasurisë nga personat përgjegjës sipas legjislacionit përkatës.

Gjatë vitit 2023 Qendra Kombëtare e Biznesit duke pasur në fokusin e saj përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ka marrë masa për kryerjen e trajnimeve të brendshme mbi përdorimin e sistemit,

ndjekjen e webinarëve të njoftuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike dhe ndjekjen e trajnimeve dhe shkëmbimin e eksperiencave jashtë vendit me qëllim rritjen e cilësisë së punës, dhe konkretisht:

Në periudhën Gusht 2023, janë kryer një cikël trajnimesh për Specialistët në Sektorin e Regjistrimit të Biznesit, Drejtoria e Regjistrimit të Biznesit Lejeve/Licencave/Autorizimeve për përmirësimin e sistemit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, me tematika specifike si vijon:

- *Marrja e aplikimeve online, detajet e aplikimit, çështje të aprovuara, çështje të refuzuara, masat administrative.*
- *Dokumentet e subjektit, dokumente të dërguar në QKB, biznese në çregjistrim.*
- *Aplikime të njëkohshme, personat e ndaluar, statistika, statusi i bilancit.*

Gjithashtu në të njëjtën periudhë, janë kryer trajnime për Specialistët në Sektorin e Lejeve/Licencave/Autorizimeve, Drejtoria e Regjistrimit të Biznesit Lejeve/Licencave/ Autorizimeve me tematika si vijon:

- *Çështjet e mia online, të gjitha çështjet, Licenca/Leje të lëshuara, Autorizime, Licenca/Leje info, dosjet e aplikimit.*

Nëpunësit e Qendrës Kombëtare të Biznesit, me qëllim shkëmbimin e informacionit kanë marrë pjesë në takime dhe grupe pune të zhvilluara nga organizma ndërkombëtar, dhe konkretisht:

- Pjesëmarrje në grupin e punës të organizuar nga EBRA në lidhje me impaktin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, të zhvilluar në Lisbonë. Në këtë grup pune një fokus të vecantë kishte rëndësia e të dhënave të Regjistrave të Pronarëve Përfitues si mekanizëm për të luftuar korrupsionin dhe vendimarrja e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë e cila hoqi aksesin publik për regjistrin e pronarëve përfitues, si pasojë e ndërhyrjes së tyre në të drejtën për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- Pjesëmarrje në takimin e grupit të punës të EBRA për “Platformën e Re” nga ku u diskutua me të gjithë anëtarët pjesëmarrës rreth ndërtimit të platformës së re, e cila konsiston në aksesin për marjen e informacionit dhe dokumentacionit të vlefshëm ligjorë në regjistrin tregtar të secilit shtet pjesëmarrës, nga subjektet e shteteve pjesëmarrës në “Platformën e Re”.
- Pjesëmarrje në takimin EBRA të zhvilluar në Danimarkë mbi regjistrimin e Pronarëve Përfitues. Në këtë takim shtetet anëtare shkëmbyen eksperiencat e tyre lidhur me procesin e regjistrimit dhe identifikimit të pronarëve përfitues dhe masat ndëshkuese në rast të mosregjistrimit të tyre.
- Gjithashtu në Qershor 2023, përfaqësues të Qendrës Kombëtare të Biznesit, kanë marrë pjesë në një trajnim gjithëpërfshirës lidhur me metodologjinë e re të OGP-së, të organizuara nga Ministria e Shtetit për Standartet e Shërbimeve, me tematika si, hartimit dhe

implementimit të masave në planet kombëtare etj, strategjitë e komunikimit dhe vizibilitetit me publikun të këtyre masave dhe planeve, etj.

8. Analiza e realizimit të treguesve ekonomiko-financiar

Në zbatim të nenit 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit Nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, QKB, ushtron aktivitetin buxhetor në programin buxhetor “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”.

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat e QKB-së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, sipas programimit të bërë për vitin 2023.

Fondet buxhetore të ndryshuara për vitin 2023 për QKB-në në total janë 124,353,209 lekë prej të cilave 122,353,209 lekë janë shpenzimet korrente dhe 2.000.000 lekë për shpenzime kapitale. Këto fonde sipas zërave të strukturës buxhetore paraqiten sipas tabelave të mëposhtme, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre për vitin 2023.

Tabela Nr.1. “Shpenzimet korrente dhe kapitale & të ardhurat”

Llogaria	E M E R T I M I	Buxheti i vitit 2023			
		PLAN	FAKT	Diferenca	%
6009999	SHPEZIME KORRENTE	122,353,209	99,782,572	23,570,637	81,55%
2319999	SHPEZIME KAPITALE	2,000,000	118,835	1,881,165	5,94%
7119999	TE ARDHURAT	152,264,664	143,496,345	8,768	94%

Referuar Tabelës Nr.1, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente për vitin 2023 është në masën 81.55 %. dhe për shpenzimet kapitale është në masën 5.94%. Të ardhura janë realizuar në masën 94% dhe janë derdhur 100% në buxhetin e shtetit.

9. Objektivat për vitin 2024

Qendra Kombëtare e Biznesit me qëllim ushtrimin e kompetencave në përmbushje të misionit të saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka hartuar dokumentin e objektivave për vitin 2024, ku janë përcaktuar objektivat e mëposhtme:

- Përmirësimi i sistemeve, faqes së web, modulit të statistikave duke përfshirë të tre regjistrat të Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe ndërveprimi elektronik me palë të treta për të lehtësuar procedurat;
- Konsultimi i propozimeve për ndryshime ligjore dhe miratimi i tyre në kuadër të procesit të Riinxhinierimit dhe Derregullimit. Ligji Nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 9723, 03.05.2023 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, Ligji 131/2015 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” i ndryshuar;
- Certifikimi ISO 9001:2015;
- Raportimi për kapitujt që Qendra Kombëtare e Biznesit është anëtare dhe ka detyrimin e dhënies së një kontributi të herëpashershëm kur kërkohet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë etj;
- Përfaqësimi dhe dhënia e kontributit për hartimin e strategjisë kombëtare për parandalimin e pastrimin të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030;
- Përmirësimi i ofrimit të asistencës së vazhdueshme për subjektet përsa i përket procesit të regjistrimit të biznesit, licencimit/lejimit të biznesit dhe regjistrimit të pronarëve përfitues;
- Rritja e cilësisë së shërbimit ndaj subjekteve nëpërmjet fushatave sensibilizuese. Krijimi i fushatave informuese dhe ndërmjetësuese për informacione mbi shërbimet që ofrohen nga QKB si dhe rritjes së përqindjes së popullimit të Regjistratit të Pronarëve Përfitues;
- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore duke identifikuar nevojën për trajnime dhe ndjekjen e tyre sipas fushave të përgjegjësisë.

ANEKS 1

NR	SHËRBIMET E PËRMIRËSUARA	PËRMIRËSIMET E ARRITURA
REGJISTRI TREGTAR		
1	Aplikim për regjistrimin fillestar të personit fizik / Application for the initial registration of the physical person	Për këto shërbime është bërë e mundur kthimi i paplotë i aplikimit në llogarinë e subjektit/aplikantit në e-Albania, plotësimi i saj nga subjekti/aplikanti dhe rikthimi në regjistrin tregtar. Pas çdo veprimi të kryer nga individ/subjekti në llogarinë e tij në e-Albania, ai njoftohet në lidhje me statusin e aplikimit, tek “mesazhet e mia” në llogarinë e tij në e-Albania, me mesazhe në numrin e telefonit dhe adresën e email-it të deklaruara në e-Albania. Dokumenti i pezullimit/refuzimit të aplikimit individit i është dërguar në hapësirën “Dokumentat e mia”. Gjithashtu pas mbarimit të afatit 21 ditor është bërë e mundur që aplikimi të kthehet në regjistër për refuzim automatik.
2	Aplikim për ndryshim të regjistrimit të Personit Fizik	
3	Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuar, dhe të thjeshta	
4	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK)	
5	Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive aksionare	
6	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit për shoqëritë aksionare (SHA)	
7	Aplikim për regjistrimin fillestar të degëve ose zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja	
8	Aplikim për ndryshime në të dhënat e degëve ose zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja	
9	Çregjitrime të personit Juridik	
10	Çregjitrime të personit fizik	
11	Çregjistrimin e personit fizik në rast vdekje	
12	Depozitimin e pasqyrave financiare dhe auditit	
13	Aplikimin e regjistrimit të njëkohshëm për shoqëritë komandite, kolektive, me përgjegjësi të kufizuar dhe të thjeshta	
14	Aplikim për hapjen e procedurës së likuidimit	
15	Aplikim për njoftim për pushimin e përkohshëm të aktivitetit	
16	Kërkesë për aktivizim aktivitetit të pezulluar	
17	Aplikim për regjistrim fillestar të shoqërive të kursim kreditit	
	Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor	
19	Aplikim për regjistrimin fillestar të shoqërive të bashkëpunimit reciprok	
20	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit të shoqërive të kursim kreditit	
21	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit të shoqërive të bashkëpunimit reciprok	

22	Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor	
23	Aplikim për njoftimin e projekt bashkimit me përthithje me krijimin e një shoqërie të re	
24	Aplikim për njoftimin e projekt bashkimit me përthithje nga një shoqëri ekzistuese (bashkim i thjeshtë)	
25	Aplikim për njoftimin e ndarjes (ndarje në favor të shoqërive të themeluara rishtazi) faza 1	
26	Aplikim për njoftimin e projekt ndarjes (ndarje në favor të shoqërive ekzistuese) faza 1	
27	Aplikim për thirrje të aksionarëve/ortakëve për miratimin e shndërrimit (shpallja 1)	
28	Aplikim për thirrje të aksionarëve-ortakëve për miratimin e shndërrimit (shpallja 2)	
29	Regjistrim të vendimeve/akte të gjykatës, zyrës përmbartimore ose autoriteteve të tjera publike (Administratë)	
30	Regjistrim të vendimeve/akte të gjykatës, zyrës përmbartimore ose autoriteteve të tjera publike (Individ)	
31	Regjistrim të vendimeve/akte të gjykatës, zyrës përmbartimore ose autoriteteve të tjera publike (Biznes)	
32	Aplikimi për rezervim emri	
33	Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, që lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet	
34	Aplikim për transferimin e emrit te rezervuar	
35	Aplikim për miratimin e shndërrimit	
36	Aplikim për miratimin e ndarjes në favor të shoqërive të themeluara rishtazi	
37	Certifikatë regjistrimi	
38	Certifikata e cregjistrimit	Shkarkohet menjëherë nga llogaria e subjektit në e-Albania
REGJISTRI I PRONAREVE PËRFITUES		
1	Aplikim për regjistrim fillestar në Regjistrin e Pronarëve Përfitues	Për këto shërbime është bërë e mundur kthimi i paplotë i aplikimit dhe vendosja e kundravajtjes administrative e cila i shfaqet subjektit në “Dokumentat e mia” tek llogaria e tij në e-Albania. Pas mbarimit të afatit 30 ditor është bërë e mundur që aplikimi të kthehet në regjistër për refuzim automatik.
2	Aplikim për ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfitues	
3	Konfirmimin e të dhënave	Miratohet automatikisht
REGJISTRI I LEJE/LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE		
1	Aplikimin për licencë të re në Qendrën Kombëtare të Biznesit	
2	Aplikim për shtyrje afati	
3	Aplikim për transferim të lejes (leje mjedisore)	

4	Aplikimi për ndryshim të të dhënave të titullit të licencës/lejes	
5	Aplikim për shndërrim të lejes minerare kërkim-zbulimi në leje minerare shfrytëzim	
6	Aplikim për transferim të lejes minerare	
7	Aplikim për revokim vullnetar	
8	Gjurmimi i çështjeve nga qendra kombëtare e biznesit/ngarkim i mandat pageses per leje/licence	
9	Lëshim i titullit të licencës/lejes	
FAQJA WEB		
1	Formular Ankese	Janë formularë të cilët gjenden në faqen kryesore të faqes web www.qkb.gov.al ku subjektet apo individët shprehin ankesat apo kërkesat e tyre për informacion, duke bërë të mundur që këto ankesa apo kërkesa të jenë më të përmbedhura për institucionin pritës QKB.
2	Formular Kërkese Informacioni	

ANEKSI 2

Shërbimi	Të aprovuara	Çregjistrim ne Pritje DPT	Të paplota	Të refuzuara	Totali
Aktivizim i Aktivitetit te Pezulluar	5201			857	6058
Aplikim nga shoqëria përthithëse për njoftimin e miratimit të bashkimit ndërkufitar me përthithje Sipas Nenit 3(1)(a) të Ligjit Nr. 110/2012 (shoqëria që rezulton nga bashkimi është shoqëri shqiptare				2	2
Bilanci vjetor	27726			9697	37423
Çregjistrim Person Fizik	2703	509	6	6495	9713
Çregjistrim Person Juridik	152	35		334	521
Çregjistrim Shoqërie Bashkepunimi Bujqesor				2	2
Ekstrakt historik	1				1
Ending Liquidation Process				2	2
Fillim i procedurës së likuidimit për Shoqëritë e Bashkepunimit Bujqesor	1			1	2
Fillim Procedurës së Likuidimit	308			144	452
Korrigjim Dege e Shoqërisë së Huaj	27			2	29
Korrigjim Person Fizik	150			10	160
Korrigjim Shoqëri Kolektive	1				1
Korrigjim Shoqëri Anonime	148			41	189

Shërbimi	Të aprovuara	Çregjistrim ne Pritje DPT	Të paplota	Të refuzuara	Totali
Korrigjim Shoqeri Komandite	4			1	5
Korrigjim Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	448			66	514
Korrigjim Shoqerie e Thjeshte	13				13
Korrigjim Zyre Perfaqesimi e Shoqerise se Huaj	1				1
Miratimi i Bashkimit me Perthithje per Shoqeri Aksionare				6	6
Miratimi i Bashkimit me Perthithje per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	8			10	18
Miratimi i Bashkimit ne shoqeri te re per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar				15	15
Miratimi i Ndarjes Ne Shoqeri Ekzistuese per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar				3	3
Miratimi i ndarjes ne shoqeri te re per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar				9	9
Ndryshim Dege e Shoqerise se Huaj	199			190	389
Ndryshim Person Fizik	13938		8	3044	16990
Ndryshim Shoqeri Aksionare	1288		1	512	1801
Ndryshim Shoqeri Anonime me Oferte Publike	3			7	10
Ndryshim Shoqeri e Bashkepunimit Bujqesor	15			39	54
Ndryshim Shoqeri e Bashkepunimit Reciprok				1	1
Ndryshim Shoqeri e Thjeshte	28			21	49
Ndryshim Shoqeri Kolektive	1			1	2
Ndryshim Shoqeri Komandite	5			5	10
Ndryshim Shoqeri Kursim Krediti	13			56	69
Ndryshim Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	19807		6	6270	26083
Ndryshim Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar per efekt te ndarjes				5	5
Ndryshim Zyre Perfaqesimi e Shoqerise se Huaj	24			12	36
Pa Shërbim				55	55
Pezullim Aktiviteti	10833			5045	15878

Shërbimi	Të aprovuara	Çregjistrim ne Pritje DPT	Të paplota	Të refuzuara	Totali
Plotesim Ekstrakti Historik per Person Fizik	39			5	44
Plotesim Ekstrakti Historik per Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar	8			13	21
Projekt Bashkimi me Perthithje Shoqerie Aksionare	3			4	7
Projekt Bashkimi me Perthithje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar	12			62	74
Projekt Bashkimi ne Shoqeri te re me Pergjegjesi te Kufizuar				31	31
Projekt Ndarje ne Shoqeri te re per Shoqeri Aksionare	1			1	2
Projekt Ndarje ne Shoqeri te re per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	1			48	49
Projekt Ndarjeje ne Shoqeri Ekzistuese per Shoqeri Aksionare				4	4
Projekt Ndarjeje ne Shoqeri Ekzistuese per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	1			36	37
Regjistrim Dege e Shoqerise se Huaj	44			43	87
Regjistrim fillestar per efekt te ndarjes per Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar				11	11
Regjistrim Person Fizik	12671		18	3344	16033
Regjistrim Shoqeri Aksionare	20			100	120
Regjistrim Shoqeri Anonime me Oferte Publike				2	2
Regjistrim Shoqeri e Bashkepunimit Bujqesor	2			48	50
Regjistrim Shoqeri e Bashkepunimit Reciprok				37	37
Regjistrim Shoqeri e Thjeshte	21		1	38	60
Regjistrim Shoqeri Kolektive				10	10
Regjistrim Shoqeri Komandite	1			7	8
Regjistrim Shoqeri Kursim Krediti				53	53
Regjistrim Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar	4120			2720	6840
Regjistrim Zyre Perfaqesimi e Shoqerise se Huaj	8			122	130

Shërbimi	Të aprovuara	Çregjistrim ne Pritje DPT	Të paplota	Të refuzuara	Totali
Regjistrimi me kërkesë të çdo të treti të vendimeve të autoritetit	16288			954	17242
Rezervim Emri	106			127	233
Shndërrimi i Shoqërisë Aksionare në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	3			9	12
Shndërrimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në Shoqëri Aksionare	1			18	19
Shpallja I për Shndërrimin e Shoqërisë Aksionare	2				2
Shpallja I për Shndërrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar	1			51	52
Shpallja II për Shndërrimin e Shoqërisë Aksionare	2			1	3
Shpallja II për Shndërrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar	1			11	12
Transferim i Emrit të Rezervuar				17	17
Totali	116,402	544	40	40,887	157,873

ANEKSI 3

Shërbimi	Të aprovuara	Institucioni tjetër – Në proces	Të refuzuara	Terhequr nga aplikimi	Totali
Apelimi			2		2
Aplikimi I ri	2087	24	7875	142	10128
Ndryshimi	673	18	842	58	1591
Revokimi Vullnetar	75		175	1	251
Shndërrimi i lejes minerare kerkim-zbulimi			2		2
Shtyrje Afati	8	7	85		100
Totali	2,843	49	8,981	201	12,074

ANEKSI 4

Shërbimi		Subjekte Juridike			OJF			TOTALI
Aplikim për regjistrim fillestar në Regjistrin e Pronarëve Përfitues		Aplikim për regjistrim fillestar	Miraturar	2677	Aplikim për regjistrim fillestar	Miraturar	210	4622
			Refuzuar	170				
		Aplikim i njëkohshëm	Miraturar	1735		Refuzuar	60	480
			Refuzuar	250				
Aplikim për ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfitues			Miraturar	2365	Aplikim për ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfitues	Miraturar	86	2451
			Refuzuar	290		Refuzuar	23	313
Konfirmuar të dhënat	Konfirmim të dhënat për të dhënat e regjistruara në regjistrimin në Regjistrin e Pronarëve Përfitues	Aprovuar Automatikisht	83	Konfirmuar të dhënat	Aprovuar Automatikisht	3	86	
Totali				7,570			382	7,952